




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

01 Nr. 678 / 2026
01.06.2026

KRYETARI / PRESEDNIK / MAYOR

<https://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/ 200 438 14

NJOFTIM

Në bazë të neni 68, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në bazë të nenit 22 paragrafi 1.5, neni 31 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë si dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik organizon:

DËGJIM PUBLIK

për

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE – KAB 2027-2029

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut, ju ftojme që të merrni pjesë në Dëgjimin Publik për: **Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB 2027-2029.**

Dëgjimi Publik do të mbahet me datë **18 Qershor 2026** duke filluar nga ora **11:00**, në **sallën e Kuvendit të Komunës së Istogut.**

Ky Dëgjim Publik, organizohet nga Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij dokumenti, Komuna e Istogut, konkretisht Zyra për Informim ka publikuar njoftimin dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB 2027-2029 në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut, <https://istog.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/> në rubrikën - Dëgjimet Buxhetore.

Dëgjimi i parë publik është i hapur për të gjithë qytetarët e Istogut, duke përfshirë (rininë, gratë, studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, Drejtor të shkollave, biznese, fermerë, organizata joqeveritare, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj.)

Kryetari i Komunës

z. Ilir FERATI

